



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Adresa: L. "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi", Nr.15 Fier - SHQIPËRI Tel. + 355 34 410 650 ëbsite: bashkiafier.gov.al

RELACION TEKNIK

**Per zbatimin e Sistemit Mbrojtjes Ndaj Zjarri
(MNZ)**

Relacion teknik i MNZ

RELACION TEKNIK

Per zbatimin e Sistemit Mbrojtjes Ndaj Zjarri (MNZ)

Objekti: Rikonstruksioni I Shkolles "Naim Frasheri"

Adresa : Lagjia "Kastriot" Bashkia Fier

Ky projekt-ide perfshin ndertimin e rrjetit te mbrojtjes ndaj zjarrit si dhe pajisjet qe do te perdoren ne te. Investitori duhet te siguroje certifikaten e sigurise ndaj zjarrit nga autoritet lokale te sherbimit te mbrojtjes ndaj zjarrit. Te gjitha pajisjet e sistemit duhet te marrin miratimin e autoriteteve. Projekti I sistemit te marre miratimin e specialisteve perkates te MNZ.

Te gjitha lidhjet dhe pozicionet e hidranteve te brendshem dhe te jashtem dhe pajisjeve te tjera te sistemit MNZ te ndertesave duhet te kryhen sipas udhezimeve dhe nen mbikqyrjen e specialistit MNZ te zones.

Duke u mbeshtetur ne vendimin e keshillit te ministrave nr. 425 date 24.07.2015 po ju paraqesim relacionin teknike te mbrojtjes ndaj zjarrit te objektit si me poshte:

Relacion teknik te projektit arkitektonik te mbrojtjes ndaj zjarrit:

Shkolla "Naim Frasheri" ndodhet ne lagjen "Kastriot" , ne ane te rruges "LEON REI" e cila lidh kete zone me qendren e qytetit te Fierit. Rruga "LEON REI" eshte me dy sense kalimi dhe ka lirshmeri ne levizjen e mjeteve. Kjo rruge do te sherbejne per kalimin e makines se zjarrfikeses ne rast renie zjarri. Shkolla

"Naim Frasheri" perpara saj ka lulishte e cila do te sherbej si shesh grumbullimi per nxenesit ne rast renie zjarri ne objekt.

Relacion teknik te projektit konstruktive te mbrojtjes ndaj zjarrit:

Shkolla "Naim Frasheri" eshte objekt tre katesh. Godina eshte e ndertuar me konstruksion beton arme. Mbulesat e nderkateve jane te realizuara me solet beton arme.

Muret perimetral te objekteve jane te realizuara me tulle.

Duke u mbeshtetur ne vendimin e keshillit te ministrave nr. 699 dt. 22.10.2004 mbi percaktimin e rezisteces te mbrojtjes ndaj zjarrit te elementeve te objektit kemi:

Pjeset e jashtme te objektit kane rezistence te mbrojtjes ndaj zjarrit R 60.

Pjeset e brendshme te objektit kane rezistence te mbrojtjes ndaj zjarrit REI 60.

Dyert e objektit kane rezistence te mbrojtjes ndaj zjarrit RE 30.

Relacion teknik te projektit hidrike te mbrojtjes ndaj zjarrit:

- **Te pergjithshme**

Per ndertesën e siperpermendur eshte parashikuar ndertimi I nje sistemi hidrik per shuarjen e zjarrit, I cili do te furnizohet nga tubacioni kryesor i UKF-se i cili do te furnizoj rezervuaret e sistemit ndaj zjarrit. Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit perbehet nga:

- Rezervuar per sistemin e MNZ-se
- Pompe per sistemin e MNZ-se
- Fikse me pluhur fosil dhe gaz karbonik 9 kg
- Sprucator tavanor
- Kaset hidranti
- Sinjalizues automatike

- Tabela orientuese te thjeshta

Rezervuari i ujit.

Sasia e ujit per Sistemin e Mbrojtjes Ndaj Zjarrit ne ndertesën ne fjale duhet te jene te tille qe te sigurojne nje autonomi kohore te funksionimit te impiantit minimalisht 60 minuta (koha prej 60 minutash mund te ndryshohet dhe te vendoset ne konsultim me organet kompetente dhe per rrjedhoje edhe vellimi I rezerves ujore per Mbrojtjen Ndaj Zjarrit llogaritet ne funksion te kesaj kohe) me nje prurje prej 5 l/sek.

Rezervuari eshte xingato do te kete nje vellim prej 5 m³. Rezervuari duhet te pajiset me galexhante mekanike si dhe nje elektrike. Gjithashtu te pajisen me tub plastic, I cili te coje ujin qe derdhet ne rrjetin e largimit te ujrave te bardha.

- **Parametrat Hidraulike dhe fizike te elementeve te sistemit**

Llogaritjet per sistemin e Mbrojtjes Ndaj Zjarrit me hidrante UNI 45 jane bere duke marre parasysh funksionimin e gjashte hidranteve te zjarrit tip UNI 45.

Hidrantet e zjarrit jane vendosur ne menyre te tille qe cdo pike e tij te arrihet nga pika e ujit e leshuar nga rrymat e hidrantit. Hidranti vendoset ne lartesine 1.25 – 1.30 m nga dyshemeja.

Hidrantet jane vendosur ne menyre te tille qe ne qoshen me te larget te arrije hundeza e hidrantit e shoqeruar me tubin e gomes, per te leshuar rrymen e ujit te perqendruar ne nje curril te vetem ose ne forme dushi me presionin mbi 200 m kolone uji, bazuar ne Kushtet Teknike te Projektimit.

Jashte ndertesës te vendosen ne bashkepunim edhe me ndermarrjen e ujesjellesit dhe organet e tjera kompetente te fushes (si specialistet e PMNZSH) Hidrante te Jashtem, UNI 45 tip Kollone ose nentokesore, te lidhura me rrjetin shperndares te ujesjellesit te qytetit.



Hidranti i zjarrit Brenda ne objekt (tip UNI 45), duhet te kete parametrat e meposhtem:

Diametri nominal DN = 45 mm (1"1/2)


Prurja q = 3 l/sek dhe

Presioni ne vatren e zjarrit te jete \geq me 1 bar (10 m kolone uji)

Hidranti duhet te jene tip UNI 45 me tub te gomuar me gjatesi 25 m (te shihet vizatimi perkates per detajet). Te jene te vendosur ne kuti te posacme metalike me kapake me xham dhe te vendosen ne mur si ne figurat e vizatimit. Kutia ka permasat perafersisht Gjatesi x Lartesi x Thellesi – 370 x 700 x 160 mm. Kutia e hidrantit te kete te shkruar ne xhamin e saj fjalet "HIDRANT ZJARRI" si dhe poshte saj udhezimet perkatese per te perdorur pajisjen (shih figuren e meposhtme):

VENDOSJA E PAJISJEVE NE KUTI

Hidranti ka ne perberjen e vet:



Saracineska Tub I gomuar

- **Saracinesken tip UNI 45 x 2" prej bronzi** (standard 45°, me peshe 0,700kg).
- **Tubin e gomuar tip UNI 45 (ose EN 14540)**, I cili lidhet tek saracineska e mesiperme dhe ka karakteristikat si me poshte:

Diametri I brendshem 2" (DN45 mm)

Presioni shkaterrimit 45 bar

Presioni I punes 15 bar

Pesha vetem e tubit pa rakorderite e lidhjes 140 gr/ml ($\pm 5\%$)

- **Hedhesi I ujit me hundez presioni** e cila lidhet me rakorderi ne fund dhe eshte e pajisur me rregulluesin e presionit te rrymes (≥ 1 bar)

Hundeza ka karakteristikat e meposhtme:

Gjatesi rreth 37 – 40 cm

Diameter te brendshem 45 mm me lidhje DSP me hundeze 12 mm prej alumini dhe te siguroje ne vatren e zjarrit presionin minimal 1 bar.

Zakonisht jane me tre funksione te rregulluesit (leves):

Mbyllja, rryme plote, rryme e fraksionuar.

- **Linjat e furnizimit me uje** mund te jene me tubacione prej celiku te zinkuar me diameter 1 ½", 2" per me shume se nje hidrant zjarri tip UNI 70 dhe me tubacion celiku te zinkuar me diameter 2", kur ka vetem nje hydrant zjarri tip UNI 70.

Linjat kane:

Per Hidranti

Diameter 1 ½", 2" per me shume se nje hidrant zjarri tip UNI 45

Diameter 2" per nje hidrant zjarri tip UNI 45

- **Sprinklerat**

Duhet te vendosen ne korridoret e cdo kati deri ne daljet emergjente. Ne projektin e MNZ te kesaj ndertese jepet nje projekt-ide e sistemit automatik te shuarjes se zjarrit me sprinklera. Ky sistem eshte I nevojshem, por domosdoshmeria e instalimeve te tij duhet percaktuar nga specialist MNZ. Keta sprinklera do te jene me diameter 1/2 " dhe te tipit pendent (te varur). Jane te



vendosur ne tavanin e kateve te permenduara me lart.

Jane vendosur ne menyre te tille qe secili prej tyre te lage siperfaqen e dyshemese mbi 9 – 12 m², duke hedhur uje mbi dyshemene e katit ku ndodhen. Ne degezimin nga rrjeti I tubavioneve per hidrantet tek rrjeti I sprinklerave te vendoset pajisja sinjalizuese (e quajtur kambana e alarmit), qe bejne te mundur

Hapjen automatike te pompes dhe futjen ne pune te sistemit te sprinklerave ne rastin e renies se zjarrit (per kete kontaktohet edhe specialistet perkates te montimit te ketyre pajisjeve).

Sprinklerat te jene te tipit pendent (te varur); me diameter $\frac{3}{4}$ " , presion maksimal 12 bar, presioni I punes me minimum 1 (nje) bar.

Tubacionet e rrjetit te sprinklerave jane me diameter 3" per unazen kryesore dhe 2" per tubacionet shperndarese. Sprinklerat te jene per temperature 57° Censius (me ngjyre portokalli te lengut te bulbit).

SHKALLET E BRENDSHME TE SHKOLLES EKZISTUESE DO TE PERDOREN EDHE SI SHKALLE EMERGJENTE NE RAST RENIE ZJARRI NE OBJEKT. DUKE RESPEKTUAR SKEMEN E EVAKUMIT KU TREGOHET ME SHIGJATA LEVIZJA.

FIKSE 9 KG

Sistemi i Mbrojtjes Kundra Zjarrit te objektit eshte parashikuar me fikse te tipit A,B, C me peshe 9 litroshe, te cilat do te vendosen sipas projektit. Duhet patur parasysh qe keto fikse te jene te kolauduara. Gjithashtu keto fikse duhet te kolaudohen vit per vit.

Fikset e zjarrit janë bombola gazi që nuk përmbajnë gaz djegës. Ato përmbajnë kryesisht shkumë që shërben për shuarjen e zjarrit.





A

Klasi A është efektive kundër zjarreve që përfshijnë letër, dru, tekstile, dhe plastike.

B

Klasi B është efektive kundër zjarreve të lendeve të djegshme. Këto mund të jenë zjarre nga vaj, benzinë, vajguri, ose bojera të përfshira nga zjarri.

C

Klasi C është efektive kundër zjarreve në pajisjet elektrike.

Shenim: Për çdo rast përdorimi të fiksës së MNZ duhet të patur parasysh rregulloren e përdorimit të saj.

- Fiksa gjatë përdorimit të jete një meter larg nga zjarri dhe pas përdorimit në ambient të mbyllur të bëhet ajrosja e ambientit.
- Shigjeta e manometrit duhet të jete në zonën jeshile në të kundërt duhet njoftohet subjekti i furnizimit të pajisjeve antizjarr.
- Nuk lejohet përdorimi në rrjetin elektrik mbi 1000 volt.

- Te behet rimbushja e fikses pas cdo perdorimi qofte edhe I pjesshem.
- Kryeni kolaudimin pas cdo mbarimi te garancise

Mirembajtja e perdorimit te mjeteve te shuarjes se zjarrit dhe veprimi ne rast zjarri

- Tiullari I shkolles duhet te mbaje nje regjister per kontrollin periodik ku te shenohen kontrollet e eficences se imjanteve elektrike,te ndricimit te sigurise,paralajmerimit te zjarrevekufizimin e ngarkesave qe mund te shkaktojne zjarre ne ambiente te ndryshme te shkolles.
- Te behet testi I evakuimit te pakten dy here ne ne vazhdim te vitit shkollore.
- Rruget e shpetimit duhen te mbahen vazhdimishte te boshatisura nga cdo lloi materiali dhe pengese.
- Te gjitha dyert dhe mekanizmat e hapjes ne rruget e daljes duhet te mbahen funksionale gjate periudhes se aktivitetit shkollore dhe te kontrollohen perpara fillimit te orve te mesimit.
- Ne ambientet te cilat jane depozituara apo perdoren lende te diegshmendalohet pirja e duhanit ose perdorimi I flakevete lira.
- Pervecse ne vendet e posacme nuk mund te depozitohen ene te mbajtjes se gazit ne presion apo te lendeve diekse.

Punoi:

Ing. Panajotis Agaj



Relacion teknik i MNZ